

UNMIK/RREG/2001/36
22 dhjetor 2001

RREGULLORE NR. 2001/36
MBI SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autoritetin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-ut) nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999, të ndryshuar, mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë, Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë të datës 15 maj 2001 dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën Ekzekutiv të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë të datës 13 shtator 2001,

Duke vlerësuar se institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes kanë përgjegjësi lidhur me Shërbimin Civil të Kosovës për të cilin nevojitet një legjislacion urgjent,

Duke marrë parasysh faktin se institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes nuk janë në gjendje të japin menjëherë këshilla mbi këtë çështje dhe se Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm do t'i marrë parasysh mendimet e tyre kur t'i kumtohen ato atij,

Me qëllim të themelimit të kornizës juridike dhe administrative për të lehtësuar funksionimin e një shërbimi civil efikas dhe të paanshëm në Kosovë, të bazuar në merita dhe që pasqyron karakterin multietnik të Kosovës,

Me anë të kësaj shpall sa vijon:

Kapitulli I
Përkufizimet

Neni 1
Përkufizimet

Sipas kësaj Rregulloreje:

(a) “Nëpunës civil” do të thotë çdo person i punësuar i një organi të punësimit, rroga e të cilit paguhet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, përveç për

- (i) anëtarët e Këshillit;
- (ii) duke përjashtuar personat e emëruar dhe
- (iii) anëtarët e Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

(b) “Shërbimi civil” është tema e kësaj Rregulloreje.

(c) “Organ punësimi” do të thotë çfarëdo institucion i përkohshëm i vetëqeverisjes (IPVQ) dhe çdo organ apo agjenci e tyre, çdo komunë dhe çdo organ apo agjenci e saj dhe çfarëdo organesh të pavarura apo zyrat e cekura në kapitullin 11 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, me kusht që subjektet e mëparshme të jenë organe punësimi vetëm sa i përket punonjësve, rrogat e të cilëve paguhën nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës .

“Organi i punësimit” nuk i përfshin ndërmarrjet publike, shtetërore dhe ndërmarrjet në pronësi shoqërore.

(ç) “Agjencitë ekzekutive” do të thotë agjencitë ekzekutive të themeluara në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/9 dhe 2001/19;

(d) “Përjashtim i të emëruarit ” do të thotë çdo individ i emëruar nga:

- (i) një ministër, një deputet i Kuvendit ose Kryetari i Kosovës, për të shërbyer si i emëruar politik në cilësinë e këshilltarit dhe
- (ii) Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm për të shërbyer për një periudhë kalimtare, duke përfshirë pa kufizim individët e emëruar në pajtim me nenin 6.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19,

të cilët individë nuk konsiderohen si pjesë e Shërbimit civil.

(dh) “Qeveri” do të thotë Kryeministri dhe kabineti i ministrave siç është parashtruar në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/9;

(e) “Ministri” do të thotë ministritë e degës ekzekutive të themeluara në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/9 dhe 2001/19;

(ë) “Sekretar i përhershëm” do të thotë sekretari i përhershëm i një ministrie të referuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/19;

(f) “NKN” do të thotë një nëpunës kryesor ndërkombëtar i caktuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në institucionet kalimtare të vetëqeverisjes për të shërbyer gjatë një periudhe kalimtare;

(g) “I emëruar i lartë publik” do të thotë:

- (i) Sekretarët e përhershëm të ministrave;
- (ii) Udhëheqësit kryesorë ekzekutivë të agjencieve ekzekutive dhe

- (iii) Postet e tjera të larta që mund t'i caktojë Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm për t'u emëruar nga Komisioni i Lartë Publik i Emërimeve, siç është parashtruar në shtojcën 1, paragrafi E i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19. Të emëruarit e lartë publikë janë nëpunës civilë në kuptimin e kësaj Rregulloreje dhe

(gj) “KLPE” do të thotë Komision i lartë publik për emërimet e formuar në pajtim me nenin 2.1 dhe shtojcën 1, paragrafi E i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 dhe me Rregulloren e tanishme.

Kapitulli II **Shërbimi civil**

Neni 2 Parimet udhëheqëse

2.1 Shërbimi civil do të udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

(a) Barazia: trajtim korrekt dhe i paanshëm i nëpunësve civilë dhe i të tjerëve në përputhje me ligjin;

(b) Neutraliteti politik dhe objektiviteti: shërbim besnik ndaj institucioneve të qeverisë pa frikë apo favorizim dhe pa marrë parasysh pikëpamjet politike apo anëtarësimin partiak;

(c) Sinqeriteti: mosshfrytëzim i pozitës zyrtare apo i informatave për përfitim personal a për përfitimin e të tjerëve; mosshfrytëzim i informatave apo përpjekja për t'i mashtruar të tjerët dhe mosshfrytëzim i zbulimit të informacionit të siguruar si rezultat i pozitës zyrtare, por vetëm në pajtim me detyrat zyrtare;

(ç) Ndershmëria dhe përgjegësia: përdorimi adekuat i dëshmuar i mjeteve financiare publike dhe ushtrimi i dëshmuar adekuat i kompetencave;

(d) Transparenca: garantimi se proceset qeveritare do të jenë të hapura për publikun, përveç rasteve kur parashihet ndryshe me ligj;

(dh) Merita: pranimi, përparimi dhe caktimi i detyrave brenda Shërbimit civil duhet të bëhet vetëm me anë të procedurave të ndershme, të hapura dhe konkurruese, bazuar në kriteret objektive që lidhen me punën;

(e) Jodiskriminimi: nuk lejohet kurrfarë diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, mendimit politik, prejardhjes kombëtare, etnike apo sociale, lidhjes me ndonjë komunitet nacional, pronës, lindjes, paaftësisë fizike, statusit familjar, shtatzanisë, orientimit seksual apo moshës dhe

(ë) Përfshirja: punësimi në të gjitha nivelet e Shërbimit civil duhet të pasqyrojë karakterin shumetnik të Kosovës dhe nevojën për përfaqësim të barabartë të të gjitha komuniteteve të Kosovës.

2.2 Nëpunësit civilë duhet të veprojnë në pajtim me këto parime në kontaktet e tyre me zyrtarët qeveritarë, me kolegët e tyre në shërbimin civil dhe me publikun.

2.3 Zyrtarët qeveritarë duhet të veprojnë në pajtim me këto parime gjatë kontakteve të tyre me të gjithë nëpunësit civilë.

Neni 3 Kushtet e punësimit

3.1 Dispozita të hollësishme mbi procedurat e punësimit dhe kushtet e punësimit për nëpunësit civilë do të parashtrihen në një urdhëresë të mëtejme administrative. Urdhëresa e tillë administrative, në mes tjerash, do të përfshijë kushtet vijuese:

- (a) Që vendet e lira të punës të publikohen gjerësisht në gjuhën shqipe dhe serbe;
- (b) Që organet e punësimit të formojnë juri prej 3 apo më shumë personave, me pëfaqësim të barabartë të komuniteteve në Kosovë, për të shqyrtuar kërkesat për vendet e punës dhe për listën përfundimtare, intervistimin dhe seleksionimin e kandidatëve;
- (c) Që punësimi në Shërbimin civil të rregullohet me anë të kontratave me shkrim të punësimit;
- (ç) Organet e punësimit t'u sigurojnë nëpunësve civilë vlerësime me shkrim për kryerjen e detyrave në baza vjetore;
- (d) Të ruhet fshehtësia e shënimeve të personelit dhe nëpunësit civilë të gëzojnë të drejtën e kontrollimit të shënimeve që kanë të bëjnë me ta;
- (dh) Sigurimi i tarifave të pagesës për punën jashtë orarit dhe ndalimi i punës së detyruar jashtë orarit më shumë se sa është paraparë për një javë;
- (e) Përcaktimi i të drejtave të pushimit të nëpunësve civilë, duke pëfshirë të drejtën për llojet e mëposhtme të pushimit me pagesë: pushimi vjetor, pushimi për festa zyrtare, pushimi mjekësor, pushimi për shkaqe të aksidenteve ose sëmundjes profesionale, pushimi i lehonisë ose pushimi i atësisë dhe pushimi për raste të vdekjes në familje, si dhe e drejta e pushimit pa pagesë për shkak të paaftësisë fizike.
- (ë) E drejta e nëpunësve civilë për një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm të punës.

3.2 Urdhëresa administrative do t'i saktësojë sjelljet e keqia për të cilat nëpunësit civilë mund t'u nënshtrohen procedurave disiplinore dhe masave të mundshme disiplinore që mund t'u shqiptohen.

3.3 Kontratat e punësimit në Shërbimin civil do të jenë për një periudhë kohore deri në tri (3) vjet dhe ato mund të vazhdojnë.

Neni 4
Aktiviteti politik

Nëpunësit civilë kanë të drejtë të jenë anëtarë të partive politike dhe të organizatave të tjera politike, por duhet të pëmbahen nga angazhimi i tyre aktivë në aktivitetet politike.

Neni 5
Veprimi sindikal

5.1 Nëpunësit civilë mund të jenë anëtarë të sindikatave.

5.2 Nëpunësit civilë të punësuar në polici, në shërbimet korrektuese dhe shërbimet emergjente dhe në çfarëdo kategorie të tjera të nëpunësve civilë, shërbimet e të cilëve janë shpallur si qenësore, nuk mund të bëjnë grevë ose të ndërmarrin ndonjë veprim sindikal që do t'i pengonte shërbimet në mënyrë të qenësishme.

Neni 6
Kodi i sjelljes

5.3 Nëpunësit civilë duhet t'i përmbahen kodit të sjelljes së shërbimit civil, që i është bashkëngjitur si shtojcë kësaj Rregulloreje.

Kapitulli III
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës

Neni 7
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës

7.1 Me anë të kësaj Rregulloreje formohet një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës (më tej "Këshilli").

7.2 Këshilli është njësi autonome brenda Ministrisë së Shërbimeve Publike dhe i raporton drejtpërsëdrejti minsitrit të Shërbimeve Publike. Një kopje e të gjitha këtyre raporteve i dërgohet Kryeministrit dhe Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm. Statusi i Këshillit shqyrtohet brenda afatit prej dy (2) vitesh pas themelimit të tij, me qëllim të transformimit të tij në një organ të pavarur, i cili drejtpërsëdrejti i raporton Kuvendit.

7.3 Buxheti i këshillit do të financohet nga burimet financiare të Minsitrisë së Shërbimeve Publike.

7.4 Këshillit i sigurohet një personel ndihmës për t'i ndihmuar në kryerjen e funksioneve të tij.

Neni 8 Përbërja

8.1 Këshilli përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve, që emërohen nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në konsultim me Kryeministrin. Anëtarët e Këshillit zgjedhen në bazë të aftësisë, ndershmërisë dhe përkushtimit të tyre për të krijuar një shërbim civil politikisht të panashëm në Kosovë, që bazohet në merita dhe që pasqyron karakterin shumetnik të Kosovës.

8.2 Përbërja e Këshillit duhet të pasqyrojë, aq sa është e mundur, karakterin shumetnik të Kosovës. Për këtë qëllim, së paku tre (3) anëtarë të tij emërohen nga komuniteti shqiptar i Kosovës dhe së paku dy (2) anëtarë nga komunitetet joshqiptare në Kosovë. Për një vit pas themelimit të tij një (1) anëtar i Këshillit do të jetë person ndërkombëtar, specialist në fushën e administrimit të shërbimit civil.

8.3 Nga anëtarët e mëhershëm të Këshillit, katër (4) do të emërohen për dy (2) vjet, dy (2) do emërohen për tri (3) vjet, ndërsa specialisti ndërkombëtar i referuar në nenin 8.2 të kësaj Rregulloreje do të emërohet për një (1) vit. Më vonë anëtarët e Këshillit emërohen për një afat prej dy (2) vitesh.

8.4 Gjatë shërbimit në Këshill, anëtarët nuk mund të kërkojnë apo të pranojnë ndonjë funksion zgjedhor dhe as të marrin pjesë aktive në aktivitete politike.

8.5 Anëtarët e Këshillit e zgjedhin një (1) anëtar për kryetar të komisionit.

8.6 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, në konsultim me Kryeministrin, mund ta largojë cilindo anëtar të Këshillit vetëm për shkak të:

- (a) mosaftësisë apo sjelljes së pahijshme të anëtarit;
- (b) mosveprimit të anëtarit në përputhje me parimet e parashtruara në nenin 2.1 të kësaj Rregulloreje dhe
- (c) dënimit të anëtarit për ndonjë vepër penale për të cilën parashihet dënimi me burg prej gjashtë (6) apo më shumë viteve.

Neni 9 Rregullorja e punës së Këshillit

Ministria e Shërbimeve Publike, varësisht nga miratimi i Qeverisë, i përcakton rregullat dhe procedurat e punës, të cilave duhet t'u përmbahet Këshilli, duke përfshirë rregullat dhe procedurat e zbatueshme për ankesa dhe në pajtim me nenin 11 të kësaj Rregulloreje.

Neni 10 Funksionet e Këshillit

10.1 Këshilli:

(a) I shqyrton dhe merr vendim për ankesat kundër vendimeve të organit të punësimit në pajtim me nenin 11 të kësaj Rregulloreje;

(b) Vendos në pajtim me nenin 12 të kësaj Rregulloreje nëse emërimet e nëpunësve civilë në nivel të udhëheqëve të departamentit janë bërë në përputhje me parimet e parashtruara në nenin 2.1 të kësaj Rregulloreje;

(c) Bën vlerësimin në pajtim me nenin 13 të Rregullores së tanishme lidhur me respektimin e organeve të punësimit përkritazi me parimet e parashtruara në nenin 2.1. të kësaj Rregulloreje dhe

(ç) I paraqet një raport vjetor Kryeministrit dhe Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm në përputhje me nenin 14 të kësaj Rregulloreje.

10.2 Nëpunësit e shërbimit civilë të emëruar nga “KLPE” dhe ato kategori të nëpunësve civilë të përjashtuar nga kompetenca e Këshillit me ndonjë dispozitë legjislative të mëvonshme, janë jashtë juridiksionit të Këshillit.

Neni 11 Apelimi

11.1 Nëpunësi civil i cili është dëmtuar me një vendim të organit të punësimit, duke i shkelur parimet e parashtruara në nenin 2.1 të kësaj Rregulloreje, mund t’i ankohet Këshillit për një vendim të tillë në pajtim me dispozitat e këtij neni. Çdo apelim i tillë duhet të shqyrtohet nga një juri prej tre anëtarësh të Këshillit, të cilët në emër të Këshillit e shqyrtojnë ankesën që u është drejtuar atyre.

11.2 Ministria, me miratimin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, i përcakton rregullat dhe procedurat e apelimeve në pajtim me këtë Rregullore. Ato rregulla dhe procedura duhet të sigurojnë, përveç tjerash:

(a) Se para apelimit në Këshill, nëpunësi i dëmtuar civil apo kandidati duhet t’i ketë shterruar procedurat e brendshme të apelimit të organit përkatës të punësimit, përveç nëse Këshilli e përjashton këtë kërkesë për shkak të frikës së arsyeshme të hakmarrjes, dështimit të organit të punësimit për të zgjedhur ankesën e tillë interne brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh, ose për ndonjë shkak tjetër të arsyeshëm.

(b) Që pala e dëmtuar dhe organi i punësimit të kenë mundësi t’ia paraqesin me shkrim qëndrimet e tyre Këshillit, të cilat duhet t’i vëhen në dispozicion palës kundërshtuese;

(c) Që në rastet e kontesteve të fakteve materiale, të dy palëve t’u jepet mundësia që së bashku të merren në pyetje para Këshillit, ku ata mund t’i paraqesin provat dhe dëshmitë gjatë marrjes në pyetje dhe hetimit;

(ç) Që për çdo apelim që paraqitet para tij, Këshilli brenda afatit prej nëntëdhjetë (90) ditësh pas përfundimit të procedurës së apelimit duhet të lëshojë një vendim me shkrim, duke arsyetuar vendimin e tij dhe bazën ligjore e faktike të atij vendimi;

11.3 Në rastet kur Këshilli bindet se vendimi i kundërshtuar ka shkelur parimin e parashtruar në nenin 2.1 të kësaj Rregulloreje, ai urdhëron një mjet të përshtatshëm juridik me shkrim dhe një urdhëresë që i drejtohet sekretarit të përhershëm apo përgjegjësit kryesor të organit përkatës të punësimit, i cili është përgjegjës për zbatimin e urdhrit të organit të punësimit.

11.4 Në rastet kur organi i punësimit përkatës nuk i përmbahet vendimit dhe urdhrat të Këshillit, Këshilli ia paraqet rastin Kryeministrit dhe Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

11.5 Anëtari i Këshillit i cili ka marrë pjesë si anëtar i jurisë përkitazi me emërimin e një nëpunësi civil në nivel të udhëheqit të departamentit konform nenit 12(a) të kësaj Rregulloreje nuk mund të marrë pjesë në apelimin e një vendimi të tillë.

11.6 Asgjë në këtë Rregullore nuk mund ta pengojë të drejtën e një nëpunësi civil për shqyrtimin procedural të vendimit përfundimtar administrativ në pajtim me ligjin në fuqi, me kusht që vendimi, i cili mund të apelohej konform këtij neni, nuk do të konsiderohet si përfundimtar para se Këshilli të lëshojë një vendim në përputhje me këtë.

Neni 12

Shqyrtimi i emërimeve në nivel të udhëheqësve të departamenteve

Me qëllim të shqyrtimit të emërimeve të nëpunësve civilë në nivel të udhëheqësve të departamentit për të verifikuar nëse ato emërimet janë bërë në pajtim me parimet e parashtruara në nenin 2.1 të kësaj Rregulloreje, këshilli duhet:

(a) Të përfaqësohet nga juritë prej tre (3) anëtarëve të Këshillit, të cilët do të marrin pjesë si vëzhgues në mbledhjet e çdo komisioni të emëruar për shqyrtimin e punësimit apo avancimit të kandidatëve për plotësimin e posteve të udhëheqësve të departamentit.

(b) Pas rekomandimit të jurisë përkatëse që ka vepruar si vëzhgues, Këshilli vendos nëse vendimet e komisioneve të referuara në nenin 12 (a) janë marrë në pajtim me parimet e parashtruara në nenin 2.1 dhe

(c) Menjëherë ta informojë me shkrim Kryeministrin dhe Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm për vendimet e organit të punësimit që nuk janë në përputhje me parimet e parashtruara në nenin 2.1.

Neni 13

Vlerësimi i respektimit

13.1 Me qëllim që të vlerësohet respektimi i parimeve të parashtruara në nenin 2.1 të kësaj Rregulloreje nga ana e organit të punësimit, Këshilli për çdo vit:

(a) Shqyrton një mostër të të dhënave të punësimit që i mbajnë organet e punësimit;

(b) Vëzhgon drejtpërsëdrejti një mostër të procedurave të punësimit, të avancimit dhe të procedurave të tjera disiplinore të organit të punësimit dhe

(c) Sipas nevojës, interviston personat e punëdhënësve që janë përgjegjës për vendimet e shqyrtuara nga Këshilli.

13.2 Në ratset kur Këshilli konstaton sferat që lypset korrigjuar, ai i bën rekomandime adekuate sekretarit të përhershëm përkatës, apo udhëheqësit kryesor ekzekutiv, ministrit përgjegjës dhe ministrit të Shërbimeve Publike.

13.3 Këshilli i vlerëson përgjigjet e organeve të punësimit të ofruara sipas rekomandimeve të Këshillit dhe aty ku një autoritet i punësimit pa arsye nuk i zbaton rekomandimet e tilla, Këshilli ia paraqet çështjen Kryeministrit dhe Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

13.4 Këshilli bën përpjekje që të bashkëpunojë me organet e punësimit për t'i kryer funksionet e tij në përputhje me këtë Rregullore dhe autoritetet e punësimit duhet të koepërojnë me Këshillin. Në rastet kur organi i punësimit dështon të koepërojë në këtë mënyrë, Këshilli i raporton për këtë dështim Kryeministrit dhe Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 14 Raporti vjetor

14.1 Këshilli i paraqet një raport vjetor Kryeministrit dhe Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, i cili raport duhet të përshijë aktivitetin e tij dhe:

- (a) Një vlerësim të organeve të punësimit lidhur me respektimin e parimeve të parashtruara në nenin 2.1 të kësaj Rregulloreje;
- (b) Rekomandimet për avancime dhe
- (c) Çështje të tjera që mund t'i kërkojë Kryeministri apo Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

14.2 Raporti i Këshillit i vihet në dispozicion publikut në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

Neni 15 Kompetencat e Këshillit

15.1 Me qëllim të ushtrimit të funksioneve të tij konform nenit 10 të kësaj Rregulloreje Këshilli mund:

- (a) Të vizitojë çdo vend ku janë të punësuar nëpunësit civilë;
- (b) Të ketë qasje dhe t'i kontrollojë të dhënat me shkrim lidhur me punësimin, emërimin, procedurat disiplinore dhe avansimin e nëpunësve civilë ose lidhur me shqyrtimin dhe vendimet e ankesave dhe
- (c) Të intervistojë çdo nëpunës civil apo të shkarkojë të emëruarin i cili mund të ketë informata që kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për ushtrimin e funksioneve të Këshillit.

15.2 Këshilli i jep sekretarit të përhershëm apo nëpunësit kryesor ekzekutiv të organit përkatës të punësimit një njoftim të arsyeshëm për çfarëdo vizite apo kerkese të informatave, duke cekur llojin e informatave të cilat i kërkon dhe nëpunësit civilë që kërkohen për intervistë.

Kapitulli IV

Komisionit për emërimë të larta publike

Neni 16

Emërimi i anëtarëve të KLEP-së

16.1 Përbërja e KLEP-së (Komisioni i Lartë Publik për Emërimë) duhet të jetë në pajtim me shtojcën 1, paragrafi D i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, duke përfshirë tre (3) anëtarë ndërkombëtar dhe tre (3) qytetarë eminentë të Kosovës, të cilët emërohen nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

16.2 Mandati i emërimit të anëtarëve të KLEP-së që emërohen nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm është dy (2) vjet, me mundësi të përtëritjes edhe për dy (2) vjet të tjera.

Neni 17

Kompensimi i anëtarëve të KLEP-së

17.1 Ministrave ose anëtarëve ndërkombëtarë të KLEP-së nuk u paguhet kurrfarë kompensimi.

17.2 Një honorar mund t'u paguhet tre (3) qytetarëve eminentë të Kosovës në shumën të cilën e cakton ministri i Shërbimeve Publike.

Neni 18

Përfundimi i emërimeve

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund t'ia ndërpresë mandatin çdo anëtar të KLEP-së të emëruar nga ai vetëm për shkak të paaftësisë profesionale ose sjelljes së pahijshme apo pasi të jetë shpallur fajtor për ndonjë kundërvajtje penale për të cilën parashihet dënimi me burg prej gjashtë (6) muajve apo më tepër.

Neni 19

Mbledhjet dhe votimi

19.1 Sekretariati i KLEP-së i cakton mbledhjet e KLEP-së kur Kryeministri e konsideron këtë të nevojshme .

19.2 Kuorumi i mbledhjeve të KLEP-së është shtatë (7) anëtarë, duke përfshirë edhe ministrin nën ministrinë e të cilit kandidati i emëruar duhet të shërbejë dhe së paku një (1) anëtar që i përfaqëson komunitetet joshqiptare të Kosovës.

19.3 Kryeministri i kryeson mbledhjet e KLEP-së. Në rastet e veçanta kur KLEP duhet të takohet në mungesë të Kryeministrit, ky e autorizon një nga anëtarët e ministrisë së KLEP-së që ta udhëheqë mbledhjen.

19.4 KLEP duhet të bëjë çmos që në mbledhjet e tij të sjellë vendime me konsensus. Në rastet kur kryesuesi konstaton se nuk mund të arrihet konsensusi, atëherë çështja vëhet në votim. Emërimet dhe vendimet tjera të pavarura kërkojnë mbështetjen e votave të së paku gjashtë (6) anëtarëve prezentë në mbledhje. Në rast të votave të barabarta, atëherë vota e kryesuesit është votë vendimtare.

Neni 21

Zgjedhja e kandidatëve për emërimë

20.1 Çdo vend i lirë i punës që duhet plotësuar nga KLEP duhet të publikohet me detajet e vendit të punës, të lokacionit, me përshkrimin e vendit të punës, të ardhurat, kohëzgjatja e kontratës dhe një përshkrim i shkurtër i kualifikimeve, aftësive, diturisë dhe kualiteteve të duhura personale.

20.2 Kërkesat për emërimë i shqyrton një juri që përbëhet nga sektetarët e përhershëm të Ministrisë së Shërbimeve Publike dhe ministrisë në të cilën kandidati i emëruar duhet të shërbejë dhe një qytetar eminent i Kosovës si dhe një anëtar ndërkombëtar i KLEP-së (të dy duhet të emërohen nga Kryeministri). Derisa të emërohen sekretarët e përhershëm, funksionet e tyre do t'i ushtrojë nëpunësi kryesor ndërkombëtar përkatës. Juria i përcakton kriteret për listën përfundimtare të kandidatëve dhe përgatit një listë me jo më shumë se dhjetë (10) kandidatë që duhet ftuar për intervistë.

20.3 Juria i përcakton kriteret për intervistimin e kandidatëve dhe në bazë të intervistave të udhëhequra nga juria ajo e përgatit një listë prej tre personave, në bazë të meritave të tyre, të cilën ia rekomandon KLEP-së për emërim. Juria mund të rekomandojë edhe më pak se tre (3) veta për pranim nëse nuk ka numër të mjaftueshëm të kandidatëve të përshtatshëm.

Neni 21

Transparenca dhe udhëheqja e mirë

21.1 Anëtarët e KLEP-së i vlerësojnë kandidatët për emërimë të larta publike në mënyrë të drejtë, në bazë të meritave dhe pa paragjykitime.

21.2 Nëse një anëtar i KLEP-së ose anëtari i jurisë ka ndonjë lidhje personale apo profesionale me ndonjë kandidat, ose ka dijeni për ndonjë rrethanë tjetër që mund të ndikojë apo duket se mund të ndikojë në paanësinë e anëtarit, anëtari e shpall konfliktin e interesit dhe abstenon nga çdo lloj përfshirjeje në procesin e zgjedhjes së kandidatit në vendin e punës për të cilin kandidati është paraqitur.

21.3 Të gjitha çështjet lidhur me zgjedhjen dhe emërimin e kandidatëve shqyrtohen në fshehtësinë më të rreptë.

Neni 22

Shërbimet e sekretarisë

Ministria e Shërbimeve Publike e pajis KLEP-in me shërbime të sekretarisë dhe, sipas nevojës, zbaton masat e tilla të nevojshme, duke përfshirë nxjerrjen e udhëzimeve dhe porosive për të lehtësuar funksionimin e KLEP-së.

Kapitulli V

Dispozitat përfundimtare

Neni 23 Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të lëshojë urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 24 Ligji në fuqi

24.1 Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

24.2 Rregullorja nr. 2001/27 e datës 8 tetor 2001 mbi Ligjin Themelor të Punës në Kosovë nuk vlen për marrëdhëniet e punës në Shërbimin civil.

Neni 25 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 22 dhjetor 2001.

Hans Haekkerup,
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

SHTOJCA

RREGULLAT E MIRËSJELLJES SË SHËRBIMIT CIVIL

1. Nëpunësit civilë i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të arsyeshme, të ndershme, të paanshmme dhe në pajtim me ligjin.
2. Nëpunësit civilë i kryejnë punët e publikut në mënyrë të shpejtë, me kurtuazi, me mirësjellje, me dashamirësi dhe pa paparagjykime apo neglizhencë.
3. Nëpunësit civilë nuk duhet ta keqpërdorin funksionin e tyre zyrtar për përfitime personale apo për përfitime të tjerëve.
4. Nëpunësit civilë i përdorin mjetet publike në mënyrë të ligjshme dhe në mënyrë efikase dhe vetëm sipas autorizimeve të Organit të punësimit për të cilin punojnë.
5. Përveç rasteve kur është e nevojshme për kryerjen e detyrave zyrtare, nëpunësit civilë nuk përdorin dhe nuk japin informata që janë fituar si rezultat i pozitës së tyre zyrtare.
6. Nëpunësit civilë (nuk) duhet t'i paraqesin gabimisht apo t'i keqpërdorin informatat, apo të bëjnë orvatje për mashtrime.
7. Nëpunësit civilë nuk pranojnë nga asnjë person apo subjekt tjetër të holla, dhurata, mikpritje apo ndihma lidhur me detyrat e tyre zyrtare dhe kontaktet e bëra, përveç nga organi i punësimit për të cilin punojnë, ose informatat e fituara në detyrën e tyre.
8. Nëpunësit civilë nuk bën ta pengojnë politikën e veprimit të zyrtarëve të zgjedhur.
9. Në zbatimin e urdhërave të tyre nëpunësit civilë i respektojnë të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të drejtat e komuniteteve.
10. Nëpunësit civilë i zbatojnë udhëzimet e udhëheqësve të tyre, përveç nëse këto udhëzime janë në kundërshtim me dispozitat ligjore, të drejtat dhe liritë e njeriut ose të drejtat e komuniteteve.
11. Nëpunësit civilë nuk marrin pjesë në kurrfarë aktiviteti politik dhe publik që mund të rrezikojë ose që duket se mund të rrezikojë paanësinë e tyre.